



Ervis Gaspri

Retë

poezi

Retë
Ervis Gaspri
Poezi

Publikuar për Bibliotekën Virtuale Lezhë

Anija e bardhë

Lundron në shpirtin tim një anije e bardhë
Hap velat për botë të largëta në skaj
Mendimet zënë vend në kuvertën e zjarhtë
Era trazon velat, me të detin përshkoj

Në horizontin e muzgët shkëlqen si diell
Me velat e bardha sikur t'ish ugr i mirë
Mes detit dhe qiellit, sytë, mua mi ndjell
Vallëzon mes dallgëve që më bëjnë të lire

Lundron në shpirtin tim e bardha anije
Udhëtare galaktikash, velier vezullues
Tregtare horizontesh, rrugë pafundësije
Mikja e përkryer për shpirtin tim krijues

Diell dhe muzë

Dielli në zenit po shkëlqen
Mbush horizontin me dritë
Muza Klio po më gënjen
Shpirtit tim ajo i zë pritë

Dielli në bosht më verbon
Mbjell tek unë një shkretëtirë
Një sirenë mbi shkëmb këndon
sjell në botë një lajm të mire

Dielli në perëndim zhduket
vjen pas tij dhe errësira
muza Urania loz me yjet
shpirtin tim e kaplon dëshira

Lavdi e instiktit

Zgjohu instikt, brenda meje
Lulëzo si të ish pranverë
Zgjohu e dil prej kësaj foleje
Fluturo për në atmosferë

Vrapo brenda trupit tim
Zgjoje ditën plot me risi
Vallëzo me diellin në fluturim
Zgjo atë; që ish tek unë fëmi

Zgjohu njeri e pushto botën
Instikti jetën ta zbukuron
Zgjohu dhe ndaloje kohën
Prej instiktit; vetë jeta buron

Vdekja e dashnorëve

Sy për sy zemër në zemër
Kamë e nxehtë; gjak e dashuri
S'ka më fytyrë e nuk ka më emër
Trup në trup mishi u shkri

Përmes mishit vdes dëshira
Dy armiq që bashkë jetojnë
Për dëshirë tek errësira
Trup në trup jetën shtrëngojnë

Ditë për ditë, në çdo moment
Njëri-tjetrin sërish e gjejnë
Nën një tempull a monument
Pa dëshirë trupat shkëmbejnë

Klesidra

Eja drejt udhës së yjeve
Harroje lartësinë e ngjitu
Eja se nata perkund ëndërrat
Grimca e drites gjumin ma vret

Eja drejt harkut tim të syve
Harro madhështinë e rrëzohu!
Eja se dita përshkron marrëzinë
grimcat e errësirës dielli i ftohu

Eja drejt meje me krahë të hapur
përhumbje e dhimbje në pafundësi
Eja në pallatin e ditëve që pamë
ku vezullojnë grimcat e trupave tanë

Eja drejt rrugës së pasme të hijeve
Vallezo me njeriun që të dëshiron
Eja se nata u flet thelle kujtimeve
Mes grimcave të rërës jeta mbaron

Uliks

Psherëtimat e dimrit kumbojnë

Si fjalët e Orakullit

-Ti nuk je Uliksi

Në rrugët e një metropoli

Në një stacion fundor metroje

-Ti nuk je Uliksi

A thua rrugën kam humbur?!

Përsëri e përsëri

Përsjatjet e dështimeve

-Ti nuk je Uliksi

Në ëndrrat e rikthimeve

Në botët e humbura tashmë

Jo...Jo!

Jo, nuk jam Uliksi

E prandaj këtë jetë do ta jetoj;

Vetëm një herë

Xhaketa e vjetër

Sa herë që mendoj atë
Varrosur thellë në komodinë
Si vjeshtë e dimër jam për të
Pranverë e verë ajo mërdhinë

Sa herë që me vete nuk e kam
E stuhitë i perballoj gjithsesi
Si diçka e humbur për të jam
Që prap nuk vdes; kurrsesi!

Ajo xhaketa ime e vjeter
Më pret e palosur në komoh
Ky besim idiot dhe i verbër;
Mi mbush sytë, zemrën ma ngroh

Një puthje e trëndafiltë

Një puthje e pamundur,
Një aventurë, një jetë
Një trëndafil i përgjumur
Një puthje e vërtetë!

Një puthje vjedhacake
Që persëritet në pafundësi
Një ditë e ëmbël vjeshtake
Që ngjall jetë, ngjall dashuri

Një puthje si njemijë
Një ditë e parë me syte e tua
Që trup e mish te jemi një
Me lë të shpreh se sa të dua!

Horizonti

Mbaj frymën dhe shoh përtej
Në qiejt e vjetër kundroj të ardhmen
Mbi të shkuarën veten e gënjej
Me grimcat e dritës krijoj të vërtetën

Mbaj frymën dhe ëndërroj
Një qiell të kaltër vetëm për shpirtin
Ëndrrën e kap e me të vallëzoj
Me copëza këngësh që japin idilin

Mbaj frymën dhe shoh në hapsirë
Shoh në horizontet e syve të mi
Shoh detin, diellin... një shkretëtirë
Me formën e tyre rikthehem fëmi

Udhetim pas malit

Do ik larg nga sytë
Fluturoj në botën e re
Do ik larg nga mërzitë
Shtepinë ta bëj mbi re

Do iki, se më s'duroj
Më mirë i pa atëdhe
Se i veshur me patkoj
Pa kusur dhe pa fe

Do ik pesëmijë milje larg
Nga sytë e këmbët arrati
Në shpirt; dëshirat varg
Egon përmbushin me lavdi

Yll i vdekur

Përmby njerëzit qëndrova
Me dashuri - ngrohtësi
Dhe nga ata u verbova
Për ngrohtësi e marrëzi

Se nga trupi im u lëshua
Një dëshirë e një tërbim
Një pasion që s'u mbarua
Plot me zjarr e me vërshim

Përmby yje do të shpërthej
Vrap e hap; shpërthim - dashuri
Që sytë prap të ti mbërthej
Plot dashuri e ngrohtësi

Dhimbja

Dhimbja është mohimi i instiktit
E veshur ne vellin e artë të kujtimeve
Mohim që flet dhe buron prej mishit
E shlyer në dritën e pastër të agimeve

Dhimbjen kërkon shpirtin guximtar
Dhe detin në oqeanin e pafundesisë
Plazmohet në të e krijon margaritar
Harrohet në të e hedh zarët e rastësisë

Dhimbja na tregon që jemi akoma gjallë
Është ora e ritmit tonë fiziologjik
Te dhimbja mbahen njerëzit e rallë
Kur flasim për udhëtimin e shpirtit ciklik

(נַפְשׁ)

Ka kohë qe jam pas teje
Dhe sonte, ti do jesh e imja
Buzët e tua i puth dehja
E vallëzon lehtë te dhimbja

Ke humbur? Mos shih pas!
Largohu prej dritës...
Në vegimin tënd, vetes i flas
Ka kohë që po të ndjek

Sot shpirti yt do jete imi
Shikimi yt që më përndjek;
Lidhet nyje tek idhnimi

Fole korbash syte e tu
Edrrash qe nuk kane mbarim
Lutje yjesh qe kam kendu
Fole korbash plot shkelqim

Përpara shiut

Më jep një puthje
Jepma para se të fillojë ky shi
Që të jetë si një lutje
E ta kujtojmë këtë dashuri
Më përqafo fort; sa të dhëmbë
Shpejt, se shiu po fillon!
përqafimi yt kujton një këngë
Ku poeti shiun e mallkon
Më merr në gjirin tënd
Sdo e vë re shiun e vërshuar
Se shiu lag gjithkënd
Perveç shpirtrave të dashuruar

Merrma shpirtin, o vjeshtë
shtegto me të pa drejtim
Merr këto copa ëndrrash të thyera
Udhëto me to për në perëndim

Merrmi sytë, o vjeshtë,
thur me to vdekjen e natyrës
Merr një copë të ditës së sotme
Udhëtim në kah të kundërt të dëshirës

Merrmë për dore, o vjeshtë,
krijo tek une dëshirën e vërtetë,
merre me vete të gjithë hirin e natyrës!
Udhëtim tek ti si dëshira për jetë

Një grimcë marrëzi

Duhet një grimcë marrëzie;
Për të dalë nga vetvetja,
Për të ikur nga siguria vrasëse,
Për të gjetur horizonte lavdie
Duhet se s'bën, pak marrëzi;
Sa herë që në botë lind një njeri
Sa herë që krijohet ide te reja
Si frymëzim stuhia dhe rrufeja
Duhet të ecësh me marrëzinë
Për të parë me sytë e të ardhmes
Se veç një i marrë do pafundësinë
Siç duan femijët duart e nënës
Duhet pak marrëzi, edhe sot
Për të dalë nga ajo që na vret,
Për të bërë atë që nuk bëjmë dot,
Se veç një i marrë; qiellin e prek
Dua pak marrëzi nga gjithë bota
Ta mbledh të gjithën në një gotë
Pa të dëshirat janë të paplota
Pa marrëzinë kjo jetë është e kotë

Siluetë

Të shoh kur më kalon pranë, lehtë-lehtë
Aroma jote më gjallëron, siluetë

sytë në zgjim e zemra fort rreh
Të të puth nuk mundem dot, siluetë

Të pashë tek vrapoje me erën e mëngjesit
Dhe ndiqje me vrap rrezet e para të diellit
Më dole përpara kur po të mendoja, siluetë

Për pak mendova se s'je ëndërr po e vërtetë
Të ndjej, ku je mbi re a nën dhe, siluetë?

Të ndjej e ta prek të butën lëkurë
Të ndjej me dëshirën time më të nxehtë
Të ndjej edhe pse s'të kam njohur kurrë

Bëhu diell

Bëhu diell, ji ëndrra jote
Dil nga qerfujt e pafundëm
Mos ki drojë për të nesërmen
Lëri imitimet, bëhu diell
Bëhu diell që të krijosh
Një jetë, një ditë a një poemë
Ke mjaft kohë që të pushosh
Bëhu diell e ushqe një pemë
Bëhu diell dhe vetëm jeto
Si gjithë yjet në galaksi
Fli mbi re, ushqehu, udhëto
Bëhu diell gjithë madhështi
Bëhu diell, prano vetveten
Vrapo që nata të mos ngryjë
Bëj dashuri me të vërtetën
Bëhu diell të shohin të gjithë

Pëshpërimat e dimrit

Sa e bukur kjo ditë me diell!

Pëshpërisja ngadalë

Nga frika e dimrit

Sa i bukur zeniti në qiell!

Pëshpërisja ëmbël

Në zemrën e dimrit

Sa e bukur është vjeshta!

Pëshpërimat marrin dhenë

Në pritje të dimrit...

Equa ater

Mbi qiellin e shkurtit
Shkruhen yjet në dritë
Ti më flet për tempujt
Vrapo Margeritë!

Nëpër pyjet Saksone
A në një pllajë në Afrikë
Këndoj këngën tënde.
Vallëzo Margeritë!

Se nuk pyet për emrat
As se si lindin femijtë
Lidh botën me ëndrrat
Mallko Margeritë!

Mbi qiellin e marsit
Fluturojnë hyjnitë
Betimi sipër varrit
Vrapo Margeritë!

Asnjëherë

S'më josh dot, ti
Me ato sytë e bukur, ti
Me prekjen e qiellit, ti
Me të ëmbilin shikim, ti
S'më josh dot, kurrsesi
Në netët pa hënë, ti
Me yllin shkruar në sy, ti
Në një përrallë arabe, ti
S'më josh dot, kimerë
Me trup felini - panterë
Me këngën tënde, sirene
Në joshjen tënde, asnjëherë!

Prelud

Rri edhe sonte zemra ime
Të ndajmë shtratin dhe buzët
Të ndajmë ndjenjat më intime
Rri edhe sonte larg nga rrugët

Vjeshta që me revan na përfaqon
Shpërhap në qiell dritë-nostalgi
Kjo ndjenjë trupat na i bashkon
Na i mbush sytë plot me magji

Rri pra edhe sonte, të lutem!
Ta shtyjmë këtë dimër edhe pak
Të flemë bashke permby lulet
te ndajme mish e te ndajme gjak

Valsi i gjetheve

Trishtimi mi merr lehtë hapat
Dhe gjethet bien
Nata e ndjek ditën nga prapa
E shpirtrat shkrihen
Koha te vjeshta me hov vrapon
Dhe gjethet bien
Në vargje me lot poeti këndon
E shpirtrat ngrihen
Në qiell retë po vallzojnë me mall
Dhe gjethet bien
Vjeshta do ngelet gjithnjë përrallë
E shpirtrat shkrihen

Ah shoqja ime e udhetimit
Syte e tu, kostelacioni i orionit
Kur me ty jam, shoqja e vetmise
Shpirti yt shkelqen si simboli i lirisë
Ti, mikja e endrrave mashtruese
Me mban ne lak me fjale nikluese
Ti, perfeksion natyre ne rikrijim
Arme e nxehte e perdorur ne krim
Ah ti! shoqja e fjaleve te bukura,
Lot e dhimbje ne ditet e humbura
Per ty jetoj, mikja ime ne pafajsi
Dy shpirtra të lidhur në një stuhi
Eh ti shoqja ime e kesaj jete
Diell qe rrotullohet ne vete-vete
Vetem ti qe hijen ma tejkalon
Me rreshqet lehte e deshire krijon
Ah shoqja ime e endjes pafund
Statuje e mermerte ne horizont
E vetmja qe embel egon e lekund
Vrapo si tiger a si një rinoceront

Do të pres

Edhe sikur bota të shëmbet

Do të pres

Përtej oqeanëve

Do të pres

Te dëshira që nuk tretet

Po të pres

Te e pamundura e ëndrrave

Do të pres

Edhe sikur mos të vish

Unë, përsëri;

Me mall të pres...

muzg vjeshte

shkelqen drità e sàj
àtje ku hijet gjene shteg
enderr e ethshme à perendim?
ànije e dehur e shpirtit tim!
rruge,rruge, dhe me shum rruge
thrret si e cmendur kohà ime
gjàte e me gjàte
i shlyej àto ne kujtime
àh moj nàte vjeshte
si enderr te duà
gjer mu ne fund,ndoshtà ne shpirt
do i mbàj puthjet e tuà.

Poemë për sytë e tu

Poema është kënga
e heshtjes tënde
Këngë magjike
e një oborri në mendje

Poemë është vetëdija
e pafundësisë
Krijim dominant
në detin e rastësisë

Poemë është pergjigja
më fundore
mermer në bllok
nxjerrë nga një gurorë

Poemë është nata
me shumë ndriçim
Thjirrje për shpirtrat
që duan shpagim

Poema janë fjalët
e thëna rastësisht
Lutje ndaj zotave
përsëritur marrëzisht

Poemë është dëshira
E imja e fundit
Cigare e ndezur
fillë para gjumit

Poema janë të gjitha
meloditë e harruara
Copeza ëndrrash
në kllapi të shkruara

Poemë është dita
kur lind gjithë njerëzimi
Arrati e shpirtit
nga çdo formë trishtimi

Poemë e përkryer
janë sytë e tu të qartë
Dëshira hyjnore
në formën më të lartë

Poemë për syte e tu
e gjitha kjo jetë
Poemë për dritën,
poema e vërtetë!

Ironi e zezë

S'ke pse hidhërohesh,
Të qash me lot
Me dhimbjen shërohesh
E sheh gotën gjysmë-plot

S'ke pse arratisesh
E të endesh pafund
Me dhimbjen blatohesh
Edipi Sfinksin e mund

S'ke pse prapë kërkon
Unë të kam harruar
Mes dhimbjesh rënkon
Ky shpirt i mallkuar

S'ke pse zemërohesh
Nga këtu s'ka dalje
Me dhimbjen do mësohesh
Të mos kërkosh falje

Pra nuk ke nga shkon
Këtu ikin vitet
Zgjidhjet janë një iluzion
Pasqyrat e labirintet

E s'ke pse përpiqesh
Rebusin së zgjidh dot
Me veten përqeshesh
Një det i marrë me not

S'ke as pse përsëritësh
Çdo gjë është e kotë
Me dhimbje do ngjizësh
Njeriun në këtë botë

S'ke pse rend me vrull
Çdo gjë do të largohet
Nga dhimbja lind një yll
Flakë e hekur pagëzohet

S'ke pse kujt i beson
Çdokush ka pabesi
Nga dhimbja lulëzon
Një ideal, një rastësi

S'ke si të tërhiqesh
Çdo gjë është një rikthim
Te dhimbja do ngjitësh
Një shkallë pambarim

Prandaj s'ka të vërtetë
Asgjë nuk ka gjenezë
Mbajmë veten në jetë
Me ironinë e zezë

Hipotermia

Një siluetë femërore qëndron e shtrirë
Në një fushë me dëborë,
Në ëndrrat e amëshimit,
Në shkrirje mes vdekjes dhe ëndërrimit
Sakaq, qielli fort gjëmon
Përkthen realitetin e nga gjumi e zgjon
Përthen diellin në njemijë e një reflekse
Ndërkohë e shtrirë , ajo pret vdekjen
Një siluetë është shtrirë në një përrua
Dielli e ngroh me përsëritje kronike,
Në një poemë të ëmbël lirike
Nga gjumi mbi dëborë, ajo u zgjua

Thatësira përzhit malin e etur
Tym e flakë për në hapësirë
Gjëmon, bërtet mali i djegur
Vallëzon me flakë në errësirë

Pak lumturi

Pak lumturi të lutem!
Vetëm pak, sa për të marrë frymë
Vetëm sa një ëndërr vjeshtake
Pak lumturi do duhej
Aq sa për të vënë paqen në botë
Aq sa për të vënë fëmijë në gjumë
Jepni të gjithë pak lumturi
Aq sa japin shitësat e misrave
Aq sa japin marinarët ne lirim
Pak lumturi ju lutem!
Vetëm pak, sa të fle gjumë
Aq pak, sa një ëndrre i mjafton

Natë Gushti

Një natë gushti erëmirë
Mi premtove ëmbël hiet
Një tufe puthjesh në errësirë
Që aq bukur mbi ty sillet

Një natë gushti plot me yje
Që aq hijshëm kap instiktin
amalgamë flake e marrëzie
Perngjit shpirtin edhe mishin

Atë natë gushti pa mbarim
Kërkoj emrin tënd nga qielli
Nga qiejt bie ylli me nxitim
tek ti rend, atë natë gushti

Natën vonë

Natën vonë; vallëzoh me detin
Vallëzoh një vals për dashurinë
Natën vonë; shoh në sy qiellin
Qielli i dehur; pasqyron fëmijërinë

Një natë të vonë, këndon Sirena
Ënderr për ëndërr thërret lavdinë
E as gjaku nuk më lëviz në vena
Natën pa hënë, qyqja, s' fluturon

Natën vonë, ruajmë mbi bedena
Natën pa hënë, shpirti shtegton
Kalon mbi veteveten marrëzisht
Natën pa hënë, në delir vallëzon

Natën vonë, ringjallemi sërisht
Marrim një vals që dot nuk vdes
Nata e vonë, rikthehet pafundësisht
Një natë të vonë, deti, flakë u ndez!

Valsi i shiut

Tek po ecje nën shi të pashë...
Si një zog,
Si një flutur;
Më bëre që kokën ta kthej pas
(Dhe të ëndërroj)
Shiu përthente siluetën tënde
E ti vallëzoje;
Drejt qiellit këndoje...
Shpërhapje gëzim anë e kënd
Dhe shiu u dorëzua pas teje,
Një hap më pas,
Një rrahje zemre,
Çdo emocion u bë si vals
(Pranvera erdhi!)

Për sytë e tu

Dashuria për ty, si udhëtimi në hënë
Një eklips që dritën diellit ja ndalon
Dëshira e ëmbël është shtëpia jonë
Pasqyrë që pafund ëndjet i rikrijon

Dashuria për ty më nxiti te poezia
Një poemë në gjuhën e syve të tu
Pasioni për ty mbjell lule dashurie
Më bën të lutem duke të ëndërru

Dashuri për ty ka shpirti im pamasë
Dy sytë e tu me atë copëz magjie
Epshi për ty një vallëzim me maskë
Për sytë e tu është kjo këngë dashurie

Retë

Unë u linda e pashe qiellin
Në një cast u zgjova e pashë qiellin
Sa herë që dëshirova; unë pashë qiellin
Ty po të flas e shoh qiellin
Në cdo cast, ty të dua; te ti shoh qiellin
Përherë veç ty therras që të shoh qiellin
Siç bëjnë retë; me sy ndjek qiellin
Me to vrapoj e këndoj për qiellin
Sa jetë kërkoj e me gisht prek qiellin
Nesër, nëse do zgjohem, do të shoh qiellin
Do jetoj, do dashuroj e do shoh qiellin
Nesër, përsëri me mall, do ta shoh qiellin

